



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT KORÇË

VENDIM

Nr. 13, dt. 10.12.2017

**MBI MIRATIMIN E BUXHETIT TË KËSHILLIT TË QARKUT
PËR VITIN 2018**

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 77, Ligjit Nr.9936, dt. 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit “Për buxhetin e vitit 2018”, të Udhëzimeve të Ministrisë së Financave për zbatimin e buxhetit të vitit 2018, Vendimit të Keshillit të Qarkut nr. 10 dt. 26.07.2017 “Mbi miratimin paraprak të Programit Buxhetor Afatmesëm 2018-2020”, VKM nr. 864 dt. 23.07.2010 “Për pajisjen me numur celular të personave juridike, publike”, me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut Korçë

V E N D O S I

1. Të miratoje Planin e Buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2018 si më poshtë:

<i>Të ardhurat e Këshillit të Qarkut</i>	<i>gjithsej</i>	<i>94.3 milion lekë</i>
Nga kjo	- Transferta e pakushtëzuar	49.5 milion lekë
	- Të ardhurat vendore	44.8 milion lekë

<i>Shpenzimet e Këshillit të Qarkut</i>	<i>gjithsej</i>	<i>94.3 milion lekë</i>
Nga kjo	Funksionet e veta	
	- Për administratën e Këshillit të Qarkut	40.7 milion lekë
	- Për shpërblimin e antarëve të Kryesisë të Këshillit të Qarkut	1.0 milion lekë
	- Për investime në Këshillin e Qarkut	10.0 milion lekë
	- Kontribut bashkëfinancim në Proj. BE	40.0 milion lekë
	- Projekti STEP	0.2 milion lekë
	- Për shoqatën e të verbërve	0.5 milion lekë
	- Sherbimi i kujdesit paliativ	0.4 milion lekë
	- Për fond rezerve	1.5 milion lekë

2. Të miratoje nivelin e tarifave të shërbimeve që ofron Këshilli i Qarkut për komunitetin në funksion të realizimit të detyrave të tij mbështetur në aktet ligjore e nënligjore në fuqi sipas pasqyrës bashkangjitur.